

VENDIM
Nr. 571, datë 27.6.2013

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRCAKTIMIT TË ZONAVE TË LEJUARA
MINERARE PËR TË DREJTAT MINERARE TË MIRATUARA ME MARRËVESHJE
KONCESIONARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 pika 1 shkronja “c” të ligjit nr. 10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rastin kur një e drejtë minerare jepet me koncesion, zona e lejuar minerare përfshin sipërfaqen e shprehur me koordinata, për:

a) tërësinë e trupave, punimeve dhe objekteve ekzistuese minerare në momentin e dhënies së të drejtës minerare me koncesion;

b) tërësinë e trupave dhe objekteve minerare sipas vazhdimësisë së trupave minerare që shfrytëzohen në mënyrë racionale nga punimet kapitale minerare, të miratuara në kuadrin e marrëveshjes koncesionare dhe sipas punës kërkimore zbuluese të realizuar më pas nga koncesionari;

c) burimet minerare që janë në vazhdimësi dhe/ose të trupave dhe objekteve minerare të së njëjtës strukturë minerare të vendburimit mineral, që përfshijnë tektonikat, tektonikat shkëputëse etj., duke mundësuar shfrytëzimin racional dhe eficient në përputhje me zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Koordinatat e zonave të lejuara minerare, të përcaktuara sipas pikës 1 të këtij vendimi, vlerësohen me vendim të këshillit teknik të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

3. Me qëllim lejitimin e veprimtarisë minerare dhe plotësimin e programit koncesionar në zonën e lejuar, të përcaktuar sipas shkronjës “a” të këtij vendimi, ministri që mbulon çështjet minerare pajis koncesionarin për herë të parë me leje minerare, bazuar në procedurat standarde përkatëse për përgatitjen dhe paraqitjen e dokumentacionit për pajisjen me leje minerare.

4. Çdo ndryshim i zonës së lejuar minerare, në lidhje me parashikimet e shkronjave “b” e “c” të këtij vendimi, miratohet me urdhër të ministrit që mbulon çështjet minerare. Të gjitha ndryshimet reflektohen në aneksin përkatës të lejes minerare.

5. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha